



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:057752
Datë: 17.12.2021
Numri i dokumentit: 02526054

PN.S.nr.53/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi – kryetar i kolegjit, Xhevdet Abazi e Bashkim Hyseni – anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale ndaj të pandehurve D.G.për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, i pandehuri V.K.për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, dhe i pandehuri R.S. për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së si dhe për veprën penale Privimi i kundërligjshëm i lirisë nga nenin 196 par.3 të KPK-së, duke vendosur lidhur me ankesat e mbrojtësve të pandehurve D. G., avokat Florent Latifaj, V.K., avokat Ekrem Hoxha, dhe R.S., avokat Flakron Sylejmani, të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PS.nr. 8/2021 i datës 26.08.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 16.12.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuar ankesat e mbrojtësve të të pandehurve D. G., avokat Florent Latifaj, V. K., avokat Ekrem Hoxha, dhe R.S., avokat Flakron Sylejmani, ndërsa i aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PS.nr. 8/2021 i datës 26.08.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzën nën shenjën PPS.nr.33/2019 i datës 24.02.2021, ndaj të pandehurve D.G.për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, i pandehuri V.K.për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, dhe i pandehuri

R.S. për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së si dhe për veprën penale Privimi i kundërligjshme i lirisë nga nenin 196 par.3 të KPK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 24.03.2021, konform dispozitës së nenit 245 të KPPRK-së, ku pas leximit të aktakuzës, të njëjtit veç e veç, janë deklaruar se nuk janë fajtorë për veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj kryetarja e trupit gjykues sipas nenit 249 dhe 250 të KPPRK-së, i ka udhëzuar mbrojtësit dhe të pandehurit në të drejtën e parashtrimit të kërkesës për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave. Mbrojtësit e të pandehurve dhe i pandehuri Driton Gashi, kanë shfrytëzuar të drejtën ligjore për kundërshtim dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës, duke i paraqitur në afatin e rregullt ligjore.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special ka mbajtur seancën e shqyrtimit të dytë me datën 26.04.2021, ku në këtë seancë palët kanë bërë elaborimin e kërkesave për kundërshtimin e provave dhe hedhjen e aktakuzës dhe janë deklaruar se qëndrojnë pranë këtyre parashtrimeve, ndërsa Prokuroria Speciale ka deklaruar se i kundërshton parashtrimet e mbrojtësve dhe të pandehurve, duke i propozuar gjykatës që të vazhdohet me mbajtjen e shqyrtimit gjyqësore.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktvendimin PS.nr. 8/2021 i datës 05.05.2021, ka aprovuar I.a. - kundërshtimin e mbrojtësit të pandehurit R.S., avokat Flakron Sylejmani, për përjashtimin si provë të procesverbaleve të dëshmitarëve H. R. e datës 02.05.2019, dhe me datës 07.11.2019, deklaratat e dëshmitarëve F. F. e datës 12.03.2019 dhe më datë 01.11.2019, deklarata e dëshmitarit I. M., e datës 25.04.2019, deklarata e dëshmitarit Xh. K, e datës 02.04.2019, deklarata e dëshmitarit Sh. G., e datës 17.07.2019 dhe e datës 25.11.2019, në bazë të nenit 249 par.3 të KPPRK-së, dhe I.b - shpallën prova të papranueshme procesverbalet e deklaratave të dëshmitarëve të lartcekur, pasi që në të njëjtat deklarata dëshmitarët e lartcekur janë intervistuar në cilësinë e të dyshuarave dhe në cilësinë e të pandehurve, në kundërshti me nenin 125 të KPP-së. I.c- provat e papranueshëm do të veçohen nga shkresat e lëndës dhe provat tjera, si dhe do të mbyllen dhe nuk mundë të shqyrtohen apo shfrytëzohen në procedurë penale në rastin e ankesës kundër këtij aktvendimi në bazë të nenit 249 par.4 të KPPRK-së. II. Refuzohen si te pa bazuara kërkesat për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave të ushtruara nga i pandehuri D. G., nga mbrojtësi i të pandehurit V. K., av. Ekrem Hoxha, nga mbrojtësi i të pandehurit R.S., av. Flakron Sylejmani, shkak se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme të cilat e mbështesin dyshimin e bazuar mirë së të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen. Shqyrtimi gjyqësore në këtë çështje penale do të caktohet pasi që aktvendimi të behet i plotfuqishëm.

Ndajë këtij aktvendimi është ushtruar ankesë nga Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si dhe të mbrojtësve të pandehurve D., G., avokat Florent Latifaj, V. K., avokat Ekrem Hoxha, dhe R.S., avokat Flakron Sylejmani dhe se kjo gjykate me aktvendimin PN.S.nr.28/21 i datë 04.06.2021, ka vendsour që refuzohet si e pabazuara ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ndërsa pika -I- e dispozitivit të aktvendimi të Gjykatës Themelore në

Prishtinë – Departamenti Special PS.nr. 8/2021 i datës 05.05.2021, vërtetohet. Me rastin e paraqitjeve të ankesave të mbrojtësve të pandehurve D. G., avokat Florent Latifaj, V. K., avokat Ekrem Hoxha, dhe R.S., avokat Flakron Sylejmani, e sipas detyrës zyrtare, pika - II- e dispozitivit të aktvendimi të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PS.nr. 8/2021 i datës 05.05.2021, anulohet, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktvendimin PS.nr. 8/2021 i datës 26.08.2021, ka refuzuar si të pabazuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave të ushtruar nga i pandehuri D. G., avokat Florent Latifaj, V. K., avokat Ekrem Hoxha, dhe R.S., avokat Flakron Sylejmani, shkak se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme të cilat e mbështesin dyshimin e bazuar mirë së të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë:

- Mbrojtësi i të pandehurit D. G., avokat Florent Latifaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të lëndës dhe kësaj ankesë të hedhë aktakuzën.
- Mbrojtësi i të pandehurit V. K., avokat Ekrem Hoxha, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta anulon aktvendimin e ankimuar, dhe çështjen ta kthejë në rivendosje pse të nxjerr aktvendim për hedhjen e aktakuzës duke e aprovuar kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.
- Mbrojtësi i të pandehurit R.S., avokat Flakron Sylejmani, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes esenciale të dispozitave dhe aplikimit të gabuar të dispozitivit të KPPRK-së, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si e bazuar dhe ndryshohet aktvendimi i ankimuar si dhe të hidhet aktakuza dhe pushohet procedura penale ndaj të pandehurit.

Prokuroria e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me parashtresën PPN/L.nr.303/2021 të datës 27.09.2021, ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të pandehurve ndërsa aktvendimi i ankiamur të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa dhe gjeti se:

Në ankesën e mbrojtësit të pandehurit D. G., avokat Florent Latifaj, thekson se i pandehuri ka vepruar ne përputhje te plotë me dispozita e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjence ku është përcaktuar niveli i rrezikshmërisë dhe dëbimit me force te huajve dhe se ne rastin konkret personat e huaj paraqesin rrezik për sigurinë kombëtarë dhe për këtë i pandehuri ka dhënë rekomandime institucioneve tjera ekzekutuese te Republikës së Kosovës. I pandehuri gjate marrjen në pyetje se informatat për te cilat ata janë cilësuar si rrezik për sigurinë nacionale janë klasifikuar si tepër sekrete dhe zbulomi i tyre mundë të shkaktoj dëme për Agjencinë. Po ashtu mbrojta ceke se duhet të behet dallimi se ne rastin konkrete nuk ka pasur të bëjë me faktin se te depërtuarit do te kryejnë vepra penale këtu ne Kosovës dhe se të behet ndjekja penale ne Kosovës por ka të bëjë me vlerësimin se kanë paraqitur rrezik për sigurinë nacionale. Veprimet që i ka ndërmarrë i pandehuri kanë qene brenda fushës se kompetencave dhe se kanë pasur mbështetje ne ligj dhe se prokurori i shtetit nuk ka marrë për bazë shumë fakte te cilat shkojnë në favor te pandehurit dhe te cilat përjashtojnë përgjegjësin penale. Po ashtu vërtetohet se AKI nuk ka tejkualuar kompetenca kur ka bërë dëbimin e të huajve ne lidhje me mos informimin e Presidentit, Kryeministrit dhe Kryeprokurori te shtetit dhe se i gjithë procedura ishe bërë ne përputhje edhe me ligjin për te Huajit. Po ashtu AKI sipas nenit 3 te Ligjit për AKI nuk ka tejkualuar apo shkelur ndonjë veprim , andaj mbrojta propozon si më lartë.

Në ankesën e mbrojtësit të pandehurit V., K., avokat Ekrem Hoxha, konsideron se aktvendim i është i paqëndrueshëm për faktin se i pandehur ka vepruar brenda detyrime ligjore si dhe ne bashkëpunim edhe me institucione e tjera. Vendime me te cilët është rekomanduar nga ana e AKI-së për dëbimin e shtetas turk e me te cilat është revokuar leje qëndrimi nuk janë të nënshkrua nga ana e te pandehurit. Rrjedhimisht i pandehur në cilësinë e drejtorit te DSHAM nuk i ka kaluar përgjegjësit e tija ligjor ne lidhe me dëbimin e te huajve dhe se nuk ka kaluar kompetencat asnjë institucioni tjetër, mirëpo ka vepruar në nxjerrjen e vendimeve për revokim te leje qëndrimeve duke u bazuar pikërisht në normat e përcaktuar. Mbrojta konsideron se prokuroria nuk ka provuar figurën e veprës penale dhe se nga provat e propozuar nuk është vërtetuar përtej dyshimit mirë të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale sepse ne veprime e tija nuk formësohen elementet e veprës penale, andaj mbrojta propozon si më lartë.

Në ankesën e mbrojtësit të pandehurit R.S., avokat Flakron Sylejmani, pretendon se në aktvendimin e ankimuar nuk përmban arsyetim te mjaftueshme për te shpjeguar objektivitetin dhe po ashtu gjykata nuk ka respektuar sugjerime e Gjykatës së Apelit. Mbrojta beson se veprimet hetimore janë marrë ne kundërshtim me dispozitat e KPP, sepse aktvendim për zgjerimin e hetimeve PPS.nr.33/2019 i datës 12.06.2019 nuk përmban asnjë vulë të gjykatës dhe se ky aktvendim përmban edhe një shkelje se hetimet fillojnë me 21.10.2019 pra fillon 4 muaj pas aktvendimit dhe se kjo nuk është gabim teknik siç pretendon prokurori. Po ashtu mbrojta ne mënyre kronologjike ka paraqitur ne ankese prej faqes 3-4 (pika a, b, c, d, e) se veprimet hetimore janë marre me shkelje procedurale. Sa i përket veprës penale nga pika I dispozitivit të aktakuzës ku prokuroria provon te ndërli dhe te akuzuarin D. G, dhe R.S., kjo sipas mbrojtjes nuk qëndron dhe nuk mundë të provohet as me prova drejtpërdrejt as të tërthorta që i pandehuri te ketë pranuar ndonjë rekomandim nga i pandehuri G. apo te ketë takuar ndonjë here. Po ashtu prokuroria nën një dispozitiv janë cilësuar dy vepra penale nga neni 422 dhe 196 te KPP dhe se këtu kemi formë te posaçme te shpërdorimit që lidhet me

privimin nga liria. Po ashtu më asnjë prova nuk mund të vërtetohet dyshimi i bazuar se i pandehuri me veprimet e tija te ketë keqpërdorur detyrat apo te ketë përfituar për vetin apo tjetrin. Mbrojta e kundërshton aktakuzën sepse e njëjta nuk është marrë në përputhje me nenin 241 të KPP dhe e veprimet e te pandehur kanë qenë brenda fushë veprimtarisë se tij. Po ashtu potencon se gjykata nuk ka vendosur në lidhje me procesverbalin për dëgjimin e palës së dëmtuar përfaqësuesit te datës 20.11.2019. Mbrojta e konsideron prove të papranueshme CD, andaj mbrojta propozon si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës se Apelit për sa i përket pikës pjesës refuzuese.

Lidhur me pretendimet ankimore te mbrojtësit te te akuzuarit D. G., gjykata e Apelit, vlerëson se ne ankesën e mbrojtësit te te akuzuarit nuk pretendohet për ndonjë prove konkrete te papranueshmërisë se saj qe do te konsistonte se si e tillë është marre ne kundërshtim me dispozitat e KPP-ës.

Sa i përket pretendimeve te mbrojtësit te te akuzuarit për dyshimin e bazuar te mire, kjo gjykate pretendimet e mbrojtjes i vlerëson ne këtë faze te procedurës se janë te pabazuara për këto arsye: Nga shkresat e lendes rrjedhe se i akuzuari ngarkohet për veprën penale, nga neni 422 te KPRK-ës, - keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit. Nga rrethanat e fakteve rezulton se veprimet qe i ngarkohen te akuzuarit kane te bëjmë me cilësinë e tije si Drejtor pranë AKI-se, qe ishte si institucion kryesor ne vend qe ishte marr me rastin e 6 shtetasve turq, ne raport me rekomandimet për ndërprerjen e leje qëndrimit dhe një nga ta refuzimin e kërkesës për leje qëndrim, ku i akuzuari ne cilësinë e drejtorit te AKI-se i kishte dhënë rekomandim departamentit për te huajt pranë MPB-ës, dhe se te njëjtit ishin dëbuar nga Kosova për ne Turqi. Për këto veprime rrjedhe se i akuzuari nuk kishte informuar institucionet qe duhej informuar sipas ligjit për AKI-ne.

Gjykata duke pas për baze, këto rrethana te fakteve, dhe provat qe janë vlerësuar nga gjykata e shkalles se pare kur ka konstatuar se ka dyshim te bazuar te mire, ne raport me pretendimet e mbrojtjes, gjen se:

Pretendimi i mbrojtjes se, i akuzuari ka vepruar ne përputhje me dispozitat ligjore nga se qëndrimi i te dëbuarve ne Kosove ka përbërë rrezik për sigurinë kombëtare, për këtë gjykate nuk mund te konsiderohet i bazuar ne këtë faze te procedurës. Fillimisht kjo gjykate çështjen e rrethanës se tille ne aspektin e sigurisë kombëtare ka detyrim qe ta vlerësoj ne raport me nenin 2, te Ligjit për AKI-ne qe kjo dispozite sigurinë kombëtare e vlerëson ne kontekst te te mirave te mbrojtura qe është cenimi i territorit, rendi juridik dhe kushtetues, stabiliteti ekonomik dhe siguria ne range global ku cenohet Kosova, qe pastaj ne raport me këto vlera për sigurinë kombëtare ndërlidhen veprat konkrete penale qe munde ti cenojnë këto vlera. Ne këtë kuptim kjo gjykate vlerëson se, provat qe gjinden ne shkresat e lendes, qe janë rekomandimet për ndërprerjen e leje qëndrimeve dhe mos dhënien e leje qëndrimit, përbën rrethanën e argumentit qe ishte konsideruar se: “ shtetasit turq merren me propagandim ne dem te interesave te Kosovës dhe po ashtu propagandojnë edhe terrorizmin pranë shtetit te tyre”. Këto komunikime te dërguara nga vet i akuzuari shpërfaqin një rrethanë, propagandimin qe jo domosdoshmërishtë përbën cenim te sigurisë kombëtare sipas nenit 2 te Ligjit për AKI-ne, si dhe konstatimin se te

dëbuarit propagandojnë terrorizmin ne shtetin e tyre, ne këtë kuptim ligji për AKI-ne, parasheh ne se, “25.2 Nëse gjatë kryerjes së funksioneve të veta, AKI-ja bindet se ekziston bazë për dyshim se një person apo subjekt i caktuar ka kryer apo po kryen një vepër penale, apo po përgatitë apo organizon një vepër 13 penale që i nënshtrohet ndjekjes publike, ajo është e obliguar të njoftojë drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe prokurorin publik kompetent”, dhe kjo dispozite fare nuk e kushtëzon detyrimin për raportim te Prokurori kur vepra penale mund ete kryhet jashtë vendit siç pretendon mbrojtja ne shtetin e Turqisë, pasi qe veprat e tilla penale te terrorizimit ndiqen edhe sipas legjislacionit te Vendit tone, andaj pretendimet e mbrojtjes lidhur me faktin se institucionet nuk janë njoftuar se ka te beje me rrezikun e sigurisë kombëtare por jo për vepra penale mbështetur ne shkresat e lendes – emailt e te akuzuarit drejtuar MPB-ës, janë te paqëndrueshme.

Sa i përket pretendimit te mbrojtjes se i akuzuari nuk ka vepruar sipas qejfeve te veta por për interes te shtetit, kjo gjykate ka parasysh se ai ka pasur detyrim mbrojtjen e interesave te vendit nga institucioni i AKI-se, por se ky detyrim konsiston ne zbatimin strikt te procedurave dhe rrjedhimisht pa cenuar te drejtat e personave te tjerë, pasi qe ne rrethana kur kemi te bëjmë me faktin se është rekomanduar se shtetasit turq ne shtetin e tyre kane edhe aktivitet terrorist, ka te beje me dispozita te natyrës tërësisht tjetër ligjore qe hynë ne sferën e përgjegjësisë penale, dhe rrjedhimisht duhet ndjekur procedura e tille, nga se vet neni 2 e ka ndërlidhur rrezikimin e sigurisë kombëtare me veprat penale qe ka renditur kjo dispozite.

Sa i përket mbrojtjes se veprimet e drejtorit te AKI-se, janë shikuar nga raporti i komisionit parlamentar, gjykata një rrethane te tille e vlerëson megjithatë nuk është ne kompetencën e komisioneve parlamentare shqyrtimi i natyrës se veprimeve penale, por është mbikëqyrje e aspektit llogaridhënës te institucionit ndaj kuvendit, ndërsa raporti si i tille edhe munde te jete prove ne procedurën penale, por fakti i mbikëqyrjes nga ana e komisionit parlamentar nuk e zbeh ekzistimin e dyshimit te bazuar te mire ne këtë çështje penale për veprën qe akuzohet i akuzuari e për te cilën dyshohet se ai e ka kryer.

Pretendimi i mbrojtjes se ligji për te huajt sipas nenit 28 paragrafi 1.6, ka arsyetuar rrethanat e tilla te veprimeve ne kontekst te zhvillimeve politike sigurisë se vendit dhe nevojave imediate për reagim, siç edhe është vepruar ne këtë raste konkret, kjo gjykate pretendimet e tilla i gjen te pabazuara, për faktin se çfarëdo rrethanash nuk arsyetojnë shmangien nga procedurat e sigurisë juridike, aq me tepër qe te argumentohet mbi bazën e rrethanave politike dhe nevojave për reagim imediate, kur siç rezulton shtetasit turq ishin ndaluar dhe rrjedhimisht çfarëdo pretendimi për cenimin e sigurisë kombëtare përderisa ishin ne ndalim sipas shkresave te lendes nuk munde te rezultojë se ka ekzistuar, andaj arsyet e tilla te mbrojtjes konsiderohen te pabazuara, si arsye për tu hedhur aktakuza siç pretendon mbrojtja.

Duke qene se vet i akuzuari kishte shkruar email duke rekomanduar MPB-ën, për ndërprejren e lejeve te qëndrimit me arsyetimin se, “këta persona dyshohen edhe për aktivitete terroriste ne vendet e tyre, dhe se nga ana tjetër, nuk rezulton se kishte ndonjë kërkesë nga shteti i tyre, rrjedhe se detyrimi ishte sipas nenit 25 paragrafi 2 qe ti kalonte informacioni Prokurorit te Shtetit.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes se i akuzuari dhe AKI-ja nuk kane marr pjese ne dëbim por vetëm ne monitorim, për gjykatën e Apelit pretendimet e tilla te mbrojtjes janë te pabazuara, nga fakti se rrjedha e tërësishme e veprimeve sipas rrethanave faktike tregon rolin e AKI-se, ku i akuzuari Driton ishte Drejtor, dhe se aktakuza nuk i ve ne barre dyshim te bazuar te mire te

akuzuarin për veprim drejtpërdrejt për dëbimin, por nga rrethanat e tërësishme rezulton se sipas rekomandimeve dhe ndërprerjes se lejes për qëndrimin e të dëbuarve në Vendlind tone ka rezultuar edhe dëbimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësve të të akuzuarve, V.K.dhe R.S., dhe gjen se këto pretendime janë të pabazuara se nga provat që gjinden në shkresat e lëndës rezulton ekzistimi i dyshimit të bazuar të mirë se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen.

Bazuar në aktvendimin për refuzimin e kërkesës së mbrojtjes, gjykata e shkallës së parë në aktvendimi i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë kërkesën e paraqitura nga mbrojtësit dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme se aktakuza e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës e në bazë të gjendjes së fakteve të përshkruara si në aktakuzë, rrjedhe se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohet secili veç e veç, ndërsa tani për tani nuk ka argumente bindëse dhe që nuk përmbajnë asnjërin prej kushteve ligjore, për të cilën mund të kundërshtohet aktakuza, ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 250 par. 1 nënpar.1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPK-së.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate në aktvendimin e kundërshtuar, Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për ekzistimin e dyshimit të bazuar të mirë në raport me provat e kundërshtuara dhe drejt ka vërtetuar se ekzistojnë prova të mjaftueshme të pranueshme në aspektin ligjor-procedural, duke u bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nga veprimet e përshkruara në aktakuzë, krijohet dyshimi i bazuar të mirë për elementet qenësore të veprave penale për të cilën janë akuzuar të pandehurit dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë me të cilat i ka propozuar prokuroria në aktakuzë, e të gjitha këto tregojnë se në raport me rrethanat e ngjarjes provat e ndërlidhin të akuzuarit me veprën penale, ndërsa pretendimet e mbrojtësve të pandehurve tani janë të pabazuara, pasi që në esencë asnjëra prej pretendimeve në ankesë nuk përmban asnjë provë me të cilën do të vërtetohej e kundërta e aktakuzës, ashtu që edhe kërkesat mbi hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave janë të pa bazuar.

Ndërsa nga thëniet e tjera në ankesa se në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme të cilat mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale me të cilat ngarkohen sipas aktakuzës, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, këto thënie nuk përmbajnë asgjë konkrete përveç atakimit të aktakuzës në mënyrë të përgjithshme dhe për të gjitha rrethanat rreth prova fajësues dhe shfajësuese ndaj të pandehurve mundë të vlerësohen vetëm në shqyrtim gjyqësor pasi që tani për tani organi i aktakuzës ka sjelle dhe vlerësuar se provat dëshmojnë një dyshim të bazuar të mirë për veprat penale që mbështesin aktakuzën.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform dispozitës së nenit 416 par. 2 të KPPK-së

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:057752
Datë: 17.12.2021
Numri i dokumentit: 02526054

DEPARTAMENTI SPECIAL
PN.S.nr.53/21 të datës 16.12.2021

Bashkëpunëtori Profesional

Kryetar i kolegjit

Bajram Rexhahmetaj

Burim Ademi